

**Njoftim për përqendrim me të cilin Shoqëria për eksport-import, tregti me shumicë dhe pakicë të tekstilit dhe konfeksionit FASHION COMPANY Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, Beograd, Serbi do të fitojë kontroll mbi AB-Line sh.p.k. Sarajevë, Bosnjë dhe Hercegovinë**

**(lënda nr. 08-169/2024)**

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më datë 30.12.2024, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës ka marrë njoftim për përqendrim me të cilin Shoqëria për eksport-import, tregti me shumicë dhe pakicë të tekstilit dhe konfeksionit FASHION COMPANY Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, Beograd, me seli në bulevardin Mihajla Pupina 115b, 11070 Beograd, Republika e Serbisë *synon të fitojë kontroll të pavarur direkt mbi AB-Line sh.p.k. Sarajevë me seli në Haliloviqi 6, 71000 Sarajevë, Bosnjë dhe Hercegovinë.*

**Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit**

Shoqëria për eksport-import, tregti me shumicë dhe pakicë të tekstilit dhe konfeksionit FASHION COMPANY Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, Beograd ka veprimtari të regjistruar - tregtia e me shumicë jo e specializuar.

Në Maqedoninë e Veriut, Shoqëria për eksport-import, tregti me shumicë dhe pakicë të tekstilit dhe konfeksionit FASHION COMPANY Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, Beograd ka një shoqëri të varur të regjistruar - Shoqëria për tregti me shumicë dhe pakicë të tekstilit dhe produkteve tekstile EUROFESHN TREJD SHPK import-eksport Shkup, me seli të regjistruar në rr. Nikolla Kljusev nr. 6, kati 7, Shkup dhe me veprimtari të regjistruar - tregtia me pakicë e veshjeve në dyqane të specializuara.

AB-Line sh.p.k. Sarajevë është një shoqëri që merret me importin dhe shpërndarjen e veshjeve, këpucëve dhe aksesorëve të ngjashëm të modës, përmes rrjetit të vet të shitjes me pakicë dhe shumicë.

AB-Line sh.p.k. Sarajevë nuk ka shoqëri të lidhura të regjistruara në Maqedoninë e Veriut.

Për qëllime të vlerësimit të përqendrimit në fjalë, parashtruesi i njoftimit propozon që tregu relevant i produkteve të përcaktohet si: 1) tregu i tregtisë me pakicë të veshjeve, këpucëve dhe aksesorëve të modës në dyqane të specializuara dhe 2) tregtia me pakicë e veshjeve, këpucëve dhe aksesorëve të modës përmes postës dhe internetit.

*Bazuar në shqyrtimin paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bjerë nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.*

*Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtje dhe mendime për këtë përqendrim në Komision. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr. 54, Shkup ose me e-mail: kzk@kzk.gov.mk dhe duhet të arrijnë në Komision brenda 10 ditëve nga data e publikimit të këtij njoftimi.*

03.01.2025

Shkup